



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 201, datë 25.3.2021

P Ë R

**PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN
E RIFORCIMIT TË NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTESA (PALLAT)
NË BASHKITË DURRËS DHE KAMZË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i" dhe 36, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr.97/2019, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr.137/2020, "Për buxhetin e vitit 2021", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 1 058 293 376 (një miliard e pesëdhjetë e tetë milionë e dyqind e nëntëdhjetë e tre mijë e treqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH, për financimin e riforcimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat), të cilat janë klasifikuar si objekte të pabanueshme ose të dëmtuara rëndë apo të dëmtuara lehtë dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para, por kanë nevojë për punime rikonstruksioni ose riparime, nga bashkitë Durrës dhe Kamzë, sipas detajimit të mëposhtëm:
 - a) Bashkisë Durrës i transferohet fondi në masën 835 060 995 (tetëqind e tridhjetë e pesë milionë e gjashtëdhjetë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH;
 - b) Bashkisë Kamzë i transferohet fondi në masën 223 232 381 (dyqind e njëzet e tre milionë e dyqind e tridhjetë e dy mijë e treqind e tetëdhjetë e një) lekë pa TVSH.

2. Përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2021, në masën 211 658 675 (dyqind e njëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH, për financimin e rihforcimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat), të cilat janë klasifikuar si objekte të pabanueshme ose të dëmtuara rëndë apo të dëmtuara lehtë dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para, por kanë nevojë për punime rikonstruksioni ose riparime, nga bashkitë Durrës dhe Kamzë, sipas detajimit të mëposhtëm:
- a) Bashkisë Durrës i transferohet fondi në masën 167 012 199 (njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë milionë e dymbëdhjetë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar;
 - b) Bashkisë Kamzë i transferohet fondi në masën 44 646 476 (dyzet e katër milionë e gjashtëqind e dyzet e gjashtë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar.
3. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe bashkitë Durrës e Kamzë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

ERION BRAÇE

**MINISTRI I SHETIT
PËR RINDËRTIMIN**

ARBEN AHMETAJ

NR.PROT. 1568/1
DATË 29-3-2021

MINISTRIT TË SHTETIT PËR RINDËRTIMIN
MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË
BASHKIVE DURRËZ E KAMZË
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGAÇI

